

## **MATERIAL MËSIMOR**

**Në mbështetje të mësuesve të drejtimit mësimor**

**Ekonomi bujqësore**

**Niveli I**

**NR. 1**

**Ky material mësimor i referohet:**

➤ **Lëndës profesionale:** “Ekonomi ferme”, kl.11 (L-17-315-12)

➤ **Temave mësimore:**

- Qarkullimi i pagesave.
- Elemente të planifikimit të shitjes dhe blerjes.
- Magazinimi i produkteve.
- Shpenzimet në ferma.
- Dokumentimi i shpenzimeve në ferma.

**Përgatiti:**

**Arbana BERISHA**

**Tiranë, 2014**

## **Tema mësimore nr. 1: Qarkullimi i pagesave**

Me “pagesa“ kuptojmë shlyerjen e një detyrimi monetar në mes të dy palëve. Shlyerja e detyrimeve monetare bëhet e mundur vetëm me anë të mjeteve apo instrumenteve të pagesës. Mjeti i pagesës shpreh formën ose mënyrën e shlyerjes së detyrimeve. Mjetet e pagesës përcaktohen në ligj dhe janë të ndryshme në vende të ndryshme. Mjeti i përgjithshëm që shërben si mjet pagese është paraja. Paraja përfshin kartmonedhat e monedhat metalike, që praktikisht, njihen si para xhepi ose para në dorë. Mjete të tjera pagesash janë: çeqet, urdhërkalimet, kartat e kreditit etj. Këto mjete përjashtojnë përdorimin e parave në dorë, përdorimi i këtyre mjeteve, para së gjithash është i lidhur me funksionin e bankave. Nëpërmjet tyre ekonomitë bujqësore bëjnë pagesa pa përdorimin e parave të gatshme. Një detyrim monetar mund të lindë p.sh., nga shitja e një malli. Blerësi i mallit merr mallin dhe në këmbim i jep shitësit një nga mjetet e tjera të pagesës. Shitësi e kalon mjetin e pagesës në sistemin bankar nga ku merr paratë. Sot është krijuar një sistem i përpunuar pagesash. Sistemi i pagesave është sistemi i shlyerjes së detyrimeve monetare. Marrëdhëniet e ndryshme lindën për shlyerjen e detyrimeve monetare dhe rregullohen nga ligje. Me sistem pagesash kuptojmë tërësinë e veprimeve që merren me shlyerjen e detyrimeve monetare ndërmjet palëve. Pjesëtarë të sistemit të pagesave janë: **Subjektet ekonomike jo bankare** përfshijnë subjekte ekonomike të organizimeve të ndryshme, si ndërmarrje, korporata, shoqëri tregtare etj. **Bankat tregtare** luajnë rolin e ndërmjetësit në sistemin e pagesave. Ato sigurojnë likuiditete për zhvillimin normal të procesit të pagesave. Veprimi më i rëndësishëm i tyre është transferimi i fondeve nga njëra bankë tek tjetra. Fondet këtu përfaqësojnë llogaritë aktive ose pasive të ndërmarrjeve dhe subjekteve të tjera ekonomike. Aktivitetet ose pasivitetet shprehin detyrimet ose të drejtat që kanë bankat ndaj subjekteve ekonomike. Transferimi i fondeve bëhet gjithmonë në bazë të një urdhri pagese. **Shërbimi i llogarisë** është shërbimi që banka u ofron fermave për të hapur llogari pranë saj. Ferma vendos paratë në bankë në llogarinë përkatëse. Fermat kanë të drejtë që në bazë të urdhrave që japin, të kryejnë lëvizje në këtë llogari. Urdhri jepet nëpërmjet mjeteve të pagesës. P.sh., drejtori i fermees plotëson urdhërkalimin, një dokument nëpërmjet të cilit i jepet urdhër bankës që paratë në llogarinë bankare të saj, të kalojë në dobi të një ferme tjetër. Shërbimi i llogarisë është i detyrueshëm për bankat. **Banka qendrore** organizon sistemin ndërbankar të pagesave. Çdo bankë tregtare detyrohet të mbajë fonde në një llogari pranë Bankës Qendrore. Gjatë ditës bankat dërgojnë instrumentet e pagesave në Bankën Qendrore. Pas grumbullimit të instrumenteve të pagesës bëhet shlyerja e tyre nëpërmjet kompensimit. Kompensimi është teprica që del ndërmjet arkëtimeve dhe pagesave për çdo bankë. Për tepricën bëhet veprimi përkatës në llogarinë e bankave. Transaksionet në këto sisteme pagesash ndahen në 2 lloje: **Transaksione me pagesa periodike** që bëhen rregullisht për shuma të caktuara, p.sh., ferma u paguan punonjësve të saj çdo datë 1 ose 1 dhe 16 të çdo muaji, pagat ose pagesat periodike që bën ferma për kontributin për sigurimet shoqërore. **Transaksionet me pagesa joperiodik** që janë pagesat për transaksionet që ndodhin rastësisht dhe për të cilat vlerat ndryshojnë nga njëra pagesë në tjetrën, p.sh., ferma blen lëndën e parë të furnitorit të saj. Pas një periudhe tjetër shlyen faturat e energjisë elektrike etj. Në zgjedhjen e instrumentit të pagesës, ndikojnë karakteristikat e ndryshme që ata ofrojnë. Disa nga këto karakteristika, përveç kostos së komisioneve që paguan ferma, përfshijnë: **Shpejtësinë e shlyerjes së detyrimit**. Ferma është e interesuar që koha e përfundimit të transaksionit të jetë sa më e shkurtër. Kjo i jep asaj mundësinë të arkëtojë më shpejt paratë. **Rreziku i humbjes, shpërdorimit, gabimit ose falsifikimit që shoqëron një instrument pagese**. Këto karakteristika janë të rëndësishme sepse ato mund të bëhen shkak për mos kryerjen e transaksionit duke rrezikuar krijimin e humbjeve ose vonësive në vlerat monetare të

ndërmarrjes. **Forma fizike e instrumentit të pagesave.** Instrumenti mund të ketë formën fizike prej letre ose jo letrore. Përfitimet nga përdorimi i instrumentave të pagesës varen nga faktorë të tillë si: vlera e pagesës, largësia në të cilën ndodhen palët, transaksionit etj. Klasifikimi më i përgjithshëm është sipas formës së tyre dhe që janë në tre grupe kryesore: **Në pagesat me para në dorë** që shpesh quhet pagesë “kesh” nga anlishtja “cash, përfshihen pagesat që kryhen me kartmonedha dhe monedha metalike. Kartmonedhat dhe monedhat metalike mbeten mjete më tradicional i pagesës. Kur si mjet pagese nuk përdoret kartmonedha dhe monedha metalike, atëherë futen në skemën e pagesës bankat dhe institucionet financiarë. **Pagesa me kalim në llogari** ose pagesa të bazuara në letër ka domosdoshmëri pjesëmarrjen e bankave. Fermat i mbajnë paratë e gatshme në arkën e vet dhe në arkën e bankës. Në arkën e bankës, ferma i mban paratë në disa llogari. Sipas karakteristikave që kanë, llogaritë e mbajtjes së parave të fermës në bankë, mund ti ndajmë në dy grupe kryesore: llogaritë rrjedhëse që njihen me emrin “llogari likuiduese”. Qëllimi i llogarive rrjedhëse është kryerja e arkëtimit dhe pagesave të ndërmarrjes me të tretët. Llogaritë e depozitave që synojnë në vendosjen e parave në bankë nga ndërmarrja me ose pa afat. Ndërmarrja përfiton interesin bankar. **Pagesa elektronike** ka marrë zhvillim të madh në ditët e sotme. Përdorimi i mjeteve elektronike të tilla si: kompjuterat, bankomatet etj., është baza e përdorimit të këtyre pagesave. Nëpërmjet mjeteve të tilla elektronike mundësohet realizimi i shpejtë i transfertave të parave nga një llogari në tjetrën. Pagesat elektronike janë të shpejta në kryerjen e pagesave në shumta të mëdha duke i dhënë epërsi ndaj formave të tjera të pagesës. Sistemi i pagesave, në përgjithësi është pasqyrim i shkallës së zhvillimit ekonomik dhe në veçanti zhvillimin institucional. Në Shqipëri, përdoren këto mjete pagese pa para në dorë: çeku, urdhërkalimi, mandatarkëtimi ose urdhërderdhja, mandatpagesa, letërpagesa, letër-kredia, kartat e kreditit. Përdorimi i parave në dorë përfshin kartmonedhat dhe monedhat metalike. Kartmonedhat dhe monedhat janë paratë fizike që qarkullojnë në një ekonomi. Përdorimi nga ndërmarrja i parave të gatshme lidhet me plotësimin e dy qëllimeve: mbajtja e një rezerve parash në arkën e saj në rast nevojë, përmbushja e detyrimeve afatshkurtra që i lindin në periudha të ndryshme. Individët mund të kryejnë këto veprime me para në dorë: derdhjet mund të kryhen nga titullari i llogarisë ose çdo person tjetër në çdo bankë pa qenë nevoja e identifikimit të tij; tërheqjet mund të kryhen vetëm nga titullari i llogarisë ose nga personi i autorizuar prej tij të cilët duhet t’i nënshtrohen identifikimit. Në këtë rast, dokumentet vërtetues të veprimit janë: çeket e zakonshme ose deftesat e zakonshme të arkës. Ferma për kryerjen e pagesa me para në dorë tërheq nga sportelet e bankës kartmonedha dhe monedha për të bërë pagesa të ndryshme. Dokumenti që ndihmon në administrimin më të mirë të parave të gatshme nga ferma është buxheti i hyrje-daljeve të tyre. Ferma harton një pasqyrë ku jep përshkrimet e saj për hyrjet e daljet gjatë gjithë vitit ushtrimor. Një tjetër mjet pagese është çeku. **Çeku është një dokument me anë të cilit një person i shpallur si pranues t’i paguaj një shumë të caktuar titullarit ose një të treti (përfituesit) për të përfituar nga fondet e depozituara te pranuesi.** Çeku bën që të marrin pjesë tri palë: **Lëshuesi** që është personi që e ka plotësuar dhe nënshkruar çekun. Ky person duhet të ketë zotësi juridike. **Pranuesi ose pritësi** që është institucioni që mban fondet dhe paguan. Ky institucion zakonisht është Banka. Në praktikë thuhet se banka bën thyerjen dhe pagesën e çekut. **Përfituesi** që është ai që përfiton shumën e përcaktuar në çek. Çeku mund të jetë shprehimisht i pagueshëm për një person të emëruar ose “me të parë”. Në rastin e parë në çek duhet të shënohet indentiteti i personit për shembull, emri, mbiemri, numri i letërnjoftimit etj. Personi që përfiton shumën e shënuar në çek është i detyruar të paraqesë dokumentat e identitetit pranë sportelit të bankës. Kur është “me të parë” nuk ka specifikim përfituesi si në rastin e parë. Banka bën pagesën me t’u paraqitur çeku pranë sportelit

të saj duke mos kërkuar dokumentat e indentifikimit të përfituesit. Ligji ka përcaktuar edhe shënimet që duhet të ketë çeku. Shënimet janë të detyrueshme të sigurojnë vlefshmërinë e çekut, ato janë: tregimin e emrit “çek”, porosia për të paguar një shumë të caktuar me anë të çekut, emri i atij që duhet të paguajë zakonisht emri i bankës, vendin e pagesës me adresën e plotë dhe numrin e telefonit, tregimin e vendit, ditës, muajit dhe vitit të lëshimit të çekut, data dhe vendi i emërimit të çekut, nënshkrimin e atij që lëshon çekun. Mungesa e një prej këtyre elementëve e bëjnë çekun të pavlefshëm. Përfitues i çekut mund të jetë: **Lëshuesi** – p.sh., ferma në datën e pagesave të çdo muaji, tërheq me çek paratë në bankë. Në këtë rast, ferma është lëshuesi i çekut. Ajo i jep urdhër bankës që t’i paguajë shumën e çekut nga mjetet monetare që ka në bankë. **Një person i tretë fizik ose juridik** - në këtë rast, lëshuesi i çekut i jep urdhër bankës që t’i paguajë zotëruesit të çekut shumën e shënuar në të. P.sh., ferma blen lëndët e para dhe plotëson një çek për furnitorin me shumën e vlerës së furnizimit që është bërë. Arkëtimi ose pagimi i çekut bëhet në dy mënyra: **Arkëtimi nëpërmjet pagimit me para në dorë**, përfituesi e thyen çekun pranë sportelit të bankës duke marrë në dorë paratë. **Arkëtimi nëpërmjet kalimeve në llogari**, përfituesi i çekut mund të kërkojë që pagesa të bëhet me kalim në llogari. Banka mund të kundërshtojë pagimin e çekut kur: llogaria e lëshuesit të çekut është e shuar ose del zbuluar, ka mungesë rezerve, ka deklarim falimentimi nga lëshuesi, ka mbaruar afati i paraqitjes së çekut për pagim, firma nuk përputhet me mostrën e depozituar në bankë ose kur ka firmosur personi i paautorizuar. Dy janë drejtimit kryesore të përsosjes së këtij instrumenti:

**Garancia e lartë e shlyerjes së detyrimit.** Dihet që ekziston rreziku i mungesës së mbulesës së çekut, që sjell mospagimin e tij. Sot po gjejnë përdorim lloje çequesh që kanë mbulesë të garantuar. Sigurimi përfshin përdorimin e çeqeve me elementë dallues sigurie. Këta elementë sigurie zvogëlojnë mundësinë e falsifikimit të tij. Përparime të mëdha janë bërë edhe në standardizimin e çeqeve. Standardizimi përfshin karakteristikat e tyre fizike dhe përmbajtjen e shënimeve në të. Sot përdoren shumë lloje çequesh si:

**Çeku bankar** – është një çek që shkruhet e lëshohet nga banka me kërkesën e klientit të saj mbi llogarinë e tij rrjedhëse. Lëshimi i çekut bankar bëhet në këtë mënyrë: Titullari i fermës plotëson formularin e nevojshëm për pajisje me çek që i ofrohet në sportelin e bankës. Në këtë formular shënohen:

**Emri e mbiemri i urdhëruesit të çekut** si dhe i personit të autorizuar për kryerjen e veprimeve me llogarinë në ngarkim të së cilës lëshohet çeku.

**Emërtimi i llogarisë** – këtu përfshihet emri i fermës në ngarkim të së cilës lëshohet çeku dhe numri i saj i llogarisë.

**Mënyra e pagesës për mbulimin e vlerës së çekut** – mund të jetë në para të gatshme ose nga llogaria e urdhëruesit.

**Emri i përfituesit** – në dobi të të cilit lëshohet çeku, afresa dhe numri i llogarisë së tij.

**Nënshkrimi i urdhëruesit** të kësaj kërkesë kur çeku lëshohet në ngarkim të një ferme nënshkrimi duhet të jetë i personave të autorizuar për veprime me llogarinë. Kur ndërmarrja nuk ka llogari pranë bankës ajo derdh shumën e parave në një llogari që hapet.

**Vula ose çeku** lëshohet nga ferma ose institucione. Nënpunësi i bankës bën këto verifikime:

**Bën identifikimin e personave** në bazë të dokumentave identifikues. **Kontrollon vërtetësinë e firmave të autorizuar.** Për këtë, ai krahason nënshkrimet e kërkesës me firmat që janë depozituar në bankë. **Verifikon nëse ferma** ka gjendje të mjaftueshme parash për të mbuluar vlerën e çekut që do të lëshohet. Kur ferma nuk ka gjendje të mjaftueshme parash në llogari në bankë, ajo derdh para në llogari duke plotësuar mbulesën e çekut.

***Pajisja e titullarit të ndërmarrjes me çekun bankar.*** Kjo është faza e plotësimit të çekut. Çdo bllok çekesh ka nja numër të çaktuar çekesh, që kanë numër serie të ndryshme. Nënpunësi i bankës gjatë plotësimit të çekut bankar ndjek këtë radhë pune: ***Vulos çekun*** me vulën “Çek Bankar”. Çeku në llogarinë rrjedhëse shkruhet dhe lëshohet nga një fermë, ndërmarrje, shoqëri private, person fizik ose juridik që ka llogari bankare. Çeku i llogarisë rrjedhëse është personal dhe lëshohet nga personi që ka të drejtën e firmës për të vepruar mbi llogarinë bankare. Ferma duhet të tregohet e kujdesshme kur lëshon çeket e llogarisë rrjedhëse. Ajo i regjistron të gjitha shumatat e çeqeve të lëshuara. Kur lëshon çekun e llogarisë rrjedhëse ferma e mban kuponin e çekut. Kuponin që i bashkëngjitet çekut ka të dhënat bazë të pagesës. Kuponin ndahet nga çeku dhe mbahet nga ferma. Në çdo rast, ferma krahason shumën e vlerave të lëshuar me çeqe. Ajo krahason këtë shumë me gjendjen e parave të saj që ka në bankë. Ky verifikim krijon mundësinë e sigurimit në çdo kohë të mbulesës së çeqeve të lëshuar. Blloqet e çeqeve blihen nga ndërmarrja sipas çmimit të çaktuar nga banka. Banka pranon nga ferma fonde për depozitimin dhe njëkohësisht kryen arkëtime dhe pagesa për llogari të saj. Këto veprime mund të kryhen si brenda vendit ashtu edhe jashtë. Teknika e urdhërave për regjistrime në llogari bazohet në regjistrimin e dyfishtë të të njëjtës shumë. Pra, kemi regjistrim me drejtim të kundërt, në debi dhe në kredi, të dyja llogarive. Në këtë mënyrë, debitori shlyen kreditorin e tij. Kjo teknikë krahas çekut përfshin urdhërkalimet, tërheqjet automatike, titujt universal të pagesës dhe titujt ndërbankarë të pagesës. Urdhërkalimi është një dokument i lëshuar për një llogari rrjedhëse nga zotëruesi i saj, për kalimin e një shume parash nga llogaria e tij në dobi të një të treti. Që të përdoret urdhërkalimi është e nevojshme: Urdhëri i titullarit në bankë për kalimin e një shume të caktuar. Transferimi i fondeve përkatëse në një llogari tjetër me anë të regjistrimit të dyfishtë. Kalimi mund të jetë i thjeshtë, dmth, të përmbajë urdhërin vetëm për një veprim. Por, mund të jetë edhe i përhershëm. Në këtë rast porositësi urdhëron për kryerjen e veprimeve periodike me kusht që shuma e çdo veprimi të jetë e njëjtë, p. sh., pagesa e qirasë mujore të një shtëpie, shlyerja e një kesti kredie etj. Për të shmangur kundërshtimet e mundshme, bankat parapëlqejnë urdhërat e shkruara në formularë të parapërgatitur nga bankat. Lëshimi i urdhërkalimeve “të pambuluara” dënohet penalisht. Në rastin e mungesës së tepricës së përshtatshme urdhërkalimi pezullohet. Veprimet me urdhërkalim ndjekin këtë radhë: Urdhërkalimi plotësohet nga zotëruesi i llogarisë rrjedhëse dhe shënohen me korrektësi të gjitha të dhënat e nevojshme. Zotëruesi paraqet urdhërkalimin e plotësuar në sportelin e bankës. Nënpunësi i bankës bën verifikimin e saktësisë së plotësimit të urdhërkalimit. Ai krahason nënshkrimin e vendosur në të me nënshkrimin që është depozituar në çastin e hapjes së llogarisë. Kur nuk ka pasaktësi nënpunësi e pranon urdhërkalimin. Me parë ai verifikon mjaftueshmërinë e parave të fermës në llogari rrjedhëse. Urdhërkalimi i pranuar nënshkruhet dhe vulozet nga punonjësi i bankës. Në tërheqjet automatike nisma për tërheqjen e parave i përket jo lëshuesit për përftuesit. Në këtë rast, debitori dhe kreditori merren vesh që detyrimi monetar të shlyhet me nismën e kreditorit. Mandatarkëtimi ka të bëjë kryesisht me derdhjet e parave të gatshme në dobi të urdhëruesit ose të një të treti. Mandatarkëtimi mund të jetë i brendshëm kur urdhëruesi dhe përftuesi i kanë llogaritë në të njëjtën bankë dhe i jashtë, kur përftuesi e ka llogarinë në një bankë tjetër nga ajo e urdhëruesit. Mandatarkëtimi përgjithësisht plotësohet nga urdhëruesi. Edhe në rastin e urdhërkalimit, zbatimi i pagesës mund të kryhet me pagesë të thjeshtë dhe me pagesë të përshpejtuar. Ecuria e kryerjes së pagesës është e njëjtë me atë të pagesës me urdhërkalim. Për të kryer një pagesë me mandatarkëtim ferma duhet të plotësojë saktë të gjithë informacionin e nevojshëm të përftuesit. Ferma nëpërmjet bankës përdor edhe instrumente të tjera pagesash me kalim në llogari siç janë mandatpagesa dhe

letërpagesa.Mandatpagesa është një dokument që plotësohet nga banka për të paguar nga arka e saj një shume të caktuar një personi të shkruar në të.Letërpagesa është një urdhër i shkruar nga një titular i llogarisë me të dhëna të mjaftueshme për shumën e pagesës, qëllimin, emërtimin e saktë, numrin e llogarisë së përfituesit si dhe formën dhe afatin e pagesës.

## **Tema mësimore nr.2: Elementë të planifikimit të shitjes dhe blerjes**

Hartimi i planit të përgjithshëm të fermës kalon në disa hapa:Formulimi i qëllimeve dhe i objektivave, inventarizimi i burimeve të fermës, përcaktimi i aktiviteteve të mundshme dhe i koeficientëve teknik, vlerësimi i fitimeve bruto ose të ardhurat mbi kostot e ndryshueshme, zgjedhja e kombinimit të aktiviteteve, përgatitja e buxhetit total të fermës.Objektivat e fermerit merren parasysh kur hartohet plani dhe përgatitet buxheti.Planit dhe buxheti shërbejnë si udhëzues për arritjen e objektivave.Gjatë planifikimit fermeri synon të përshtatë organizimin e fermës në përputhje me objektivat e tij.**Objektivi kryesor i fermerëve është maksimizimi i fitimit ose i të ardhurave.**Por ka edhe objektiva të tjera specifike si: rritja e madhësisë së fermës; ruajtja e produktivitetit afatgjatë të tokës; ruajtja e pavarësisë financiare; pakësimi i nevojave për hua, sigurimi i kohës së nevojave të pushimeve etj.Hartimi i një plani të përgjithshëm bujqësor është i kushtëzuar nga kryerja e një inventari të hollësishëm të aftësive prodhuese dhe burimeve të tjera të pranishme.Këto burime përbëjnë mjetet e nevojshme për realizimin e prodhimit dhe të fitimit të parashikuar.**Toka** ka përparësinë kryesore gjatë kryerjes së inventarit të burimeve, për vetë faktin se është burimi më me vlerë.Ajo është një burim i pandryshueshëm dhe ndikon shumë në llojin dhe në numrin e aktiviteteve që do të realizohen.Inventarizimi i tokës përfshin elementët e mëposhtëm:Sipërfaqen e përgjithshme të tokës në dispozicion të fermës e ndarë në tokë arë, pemishte, ullishte, vreshta, kullota etj.; faktorët klimatikë si: sasia vjetorë reshjeve, ekspozicioni, temperatura dhe gjatësia e sezonit të kultivimit të bimëve; llojet e tokave të ndarë sipas cilësive agropedologjike të tyre si thellësia pjerrësia etj.; nivelet e pjellorisë natyrale të tokës dhe nevojat për rritjen e kësaj pjellorie;sistemi ekzistues i ujitjes, gjendja e ujit dhe perspektiva e tij;problemet e drenazhimit të tokës, si dhe masat preventive për përmirësimin dhe zgjerimin e tij në të ardhmen;praktikat ekzistuese të ruajtjes së tokës dhe nevojat për përmirësimin në të ardhmen;problemet që lidhen me mundësinë e përhapjes së dëmtuesve dhe barërave të këqija;pronësia mbi tokën.

**Inventari i ndërtesave** duhet të përfshijë të gjithë ndërtesat ekonomike që ndodhen në territorin e fermës dhe përcaktohen:madhësia, kapaciteti, qëllimi i përdorimit të tyre etj.

**Puna dhe krahu i punës** duhet analizuar si në sasi edhe në cilësi.Sasia matet me ditë, javë, muaj punë.Cilësia e punës është më e vështirë për tu matur pasi kjo ka të bëjë me aftësi të veçanta dhe përgatitjen profesionale të pjesëtarëve të familjes apo dhe punëtorëve të tjerë.

**Makineritë** janë një burim i rëndësishëm prodhues në fermë.Gjatë inventarit të tyre duhet të përcaktohet: numri i makinerive sipas llojeve, gatishmëria teknike, madhësia dhe kapaciteti i tyre, drejtimet e përdorimit etj.

**Kapitali** themelor në formën e tokës, makinerive e ndërtesave ekonomike konsiderohet si kapital i pandryshueshëm, me qenë se ai nuk mund të përdoret me lehtësi nga një drejtim përdorimi në një tjetër, me përjashtim të afatit të gjatë.Inventari i kapitalit qarkullues ose në përdorim përqëndrohet në verifikimin e sasisë së kapitalit të pranishëm për investime shtesë dhe për blerjen e imputeve të qëndrueshme që nevojiten për aktivitetin e fermës.Këtu futet si kapitali vetjak i fermerëve, ashtu dhe kapitali që mund të merret hua.

**Drejtimi gjatë kryerjes së inventarit të burimeve** ka rëndësi të veçantë. Vlerësimi i drejtimit duhet të përfshijë, jo vetëm aftësitë e përgjithshme drejtuese, por dhe aftësitë e veçanta që lidhet me secilin drejtues.

**Burimet e tjera**, aftësia e tregjeve lokale transporti e shpenzimet të veçanta, mund të jenë burime të rëndësishme që merren në konsideratë kur hartohet plani i përgjithshëm i fermës. Duke u mbështetur në inventarin e burimeve prodhuese fermeri duhet të përcaktojë llojin e aktiviteteve bujqësore e blegtorale që do të realizojë në fermën e tij. Për këtë harton një listë të aktiviteteve, në përputhje me burimet prodhuese të mundshme dhe mundësitë e tregtimit të tyre. Kujdes i veçantë tregohet në zgjedhjen e llojit të aktiviteteve për të mundësuar përdorimin racional të gjitha burimeve prodhuese. Çdo lloj aktiviteti përcaktohet mbi bazën e njësisë më të vogël prodhuese siç mund të jetë 1 ha për bimët e arave, 1 krerë në blegtori, 1 pemë apo 1 ha vreshtë në frutikulturë. Mbi këtë bazë, përcaktohen nevojat dhe kërkesat për faktorë prodhimi. Nevojat për faktorë prodhues quhen koeficientë teknikë të prodhimit në bujqësi. P.sh., koeficientët teknik për 1 ha misër do të ishin: 1 ha tokë, 1800 orë pune, 6 kv pleh fosforo-azotik, 800 m<sup>3</sup> ujë, 20 000 lekë shpenzime mekanike, 1kg kimikate etj. Po kështu, bëhen llogaritjet e nevojshme edhe për 1 krerë në blegtori, 1 pemë apo 1 ha vreshtë në frutikulturë etj. Buxheti i aktiviteteve siguron një listë të detajuar të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve që shoqërojnë një aktivitet të veçantë me qëllim që të vlerësohet dobishmëria e tyre. Me rëndësi në procesin e planifikimit është **përcaktimi i fitimeve bruto** ose i të ardhurave mbi kostot e ndryshueshme për çdo aktivitet duke bërë diferencën midis të ardhurave gjithsej dhe kostove të ndryshueshme gjithsej. Fitimi bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve për kostot e pandryshueshme dhe fitimin pasi janë paguar kostot e ndryshueshme. Faktorët fizikë, biologjikë dhe ekonomikë, janë ata që përcaktojnë kombinimet më fitimprurëse të aktiviteteve në ferma. Megjithatë, kur përcaktohet një kombinim aktivitetesh merren në konsideratë stabiliteti i të ardhurave dhe risku. Për të kuptuar parimet bazë që lidhen me zgjedhjen dhe kombinimin e aktiviteteve merren në konsideratë problemet e rajonizimit të prodhimit bujqësor, si dhe problemet e drejtimit të një ferme individuale. Ka fermerë që dëshirojnë të eksperimentojnë kombinime të ndryshme të aktiviteteve, duke hartuar disa buxhete dhe bëjnë krahasimin e tyre. Hapi i fundit dhe më i rëndësishëm i procesit të planifikimit është përgatitja e një buxheti total të fermës.

**Buxheti total i fermës** përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e biznesit. Ai përdoret në një situatë të tillë të procesit të marrjes së vendimit kur alternativat e propozuara për ndryshimin e organizimit të fermës ndikojnë në përdorimin e të gjitha burimeve prodhuese ose të pjesës më të madhe të tyre. Buxheti total i fermës përdoret në marrjen e vendimeve të tilla si: ndryshimi i strukturës së aktiviteteve prodhuese në fermë, rritjen e madhësisë së fermës, ndërtimin e një sistemi të ri ujitës, krijimin e një pentoreje etj.

Buxheti total i fermës përbëhet nga disa pjesë: plani i prodhimit bujqësor, blegtoral, i bazës ushqimore, plani i shpenzimeve, buxheti i të ardhurave neto të fermës; plani i prodhimit blegtoral përbëhet nga plani i numrit të krerëve dhe plani i prodhimit. Planin e numrit të krerëve përcakton llojin dhe numrin e kafshëve, si dhe jep një informacion për numrin e që do të blihen, lindjet, ngordhjet, therjet dhe shitjet. Bilanci i tufës për çdo lloj të gjëse së gjallë paraqitet: Gjendja në fillim + blerje + lindje = ngordhje + therje + shitje + gjendja në fund ose Gjendja në fund = gjendja në fillim + lindje + blerje - ngordhje - therje - shitje. Planin e prodhimit blegtoral përmbledh llojin e kafshëve ose produkteve blegtorale dhe destinacionin e tyre vjetor.

Planin e bazës ushqimore përdoret për të gjykuar mbi sasinë e ushqimeve që kërkohen për kafshët si dhe sasinë e ushqimeve që do të prodhohen në fermë dhe atë që do të blihet. Për të gjykuar mbi shpenzimet vjetore përdoren informacione të siguruar nga buxhetet e aktiviteteve dhe planet e

prodhimit bujqësor, blegtoral dhe plani i bazës ushqimore si dhe rregjistrimet e viteve të kaluara. Buxheti i të ardhurave neto të fermës tregon dobishmërinë e parashikuar për një plan të propozuar dhe përfshin rregullimet e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë pjesë përbërëse e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Hapat e procesit të planifikimit të tregut janë: përcaktimi i objektivave, i kohës, radhës dhe vëllimit të prodhimit, vlerën e kostove të prodhimit, parashikimin e çmimeve, vendimet e tregut.

**Përcaktimi i objektivave**-fermeri përcakton objektivat specifike që lidhen me tregun. Disa objektivat më të rëndësishme janë: Fermerët kanë si objektiv kryesor të shesin produktet e tyre me çmime më të larta dhe të blejnë faktorët e prodhimit me çmime të ulta. Një objektiv alternativ do të ishte shitja e prodhimit me një fitim ose normë fitimi të veçantë. P.sh., një prodhues mund të përpiqet të sigurojë një normë fitimi 12% ose një fitim bruto të veçantë për ha ose krerë.

**Përcaktimi i kohës dhe vëllimit të prodhimit**-plani i tregut duhet të integrohet me planin e prodhimit dhe atë financiar. Ky integrim konkretizohet nëpërmjet përcaktimit të vëllimeve të ndryshme të produkteve që do të prodhohen dhe kohës së prodhimit të përcaktuara nga plani i prodhimit. Plani i prodhimit të detajuar siguron të dhëna mbi sasinë e faktorëve që do të blihen dhe vëllimin e prodhimeve të ndryshme që do të jenë të mundshme për t'u shitur.

**Vlerësimi i kostove të prodhimit**- shërben jo vetëm për të përcaktuar objektivin e fitimit ose fitimeve gjatë planifikimit të tregut, por edhe për të përcaktuar çmimin kufi që duhet të paguhet për faktorët e ndryshëm. Për këtë është e domosdoshme që gjatë planifikimit të tregut të përdoren dy koncepte të rëndësishme të kostove të prodhimit: kostot ekonomike të të gjithë burimeve prodhuese; kostot e ndryshueshme dhe e pandryshueshme.

**Parashikimi i çmimeve të produkteve dhe faktorëve** kërkon që të kuptohen drejt konceptet bazë të kërkesës e ofertës si dhe të kuptohen ndryshimet sistematike të çmimeve për shkak të ndryshimeve sezonale dhe ciklike të tyre.

**Marrja e vendimeve të tregut**-vendimet më të rëndësishme të tregut janë: kur të shesim, ku të shesim, çfarë forme, klasifikimi ose cilësie kërkohet produkti, çfarë shërbimesh të përdoren, si të shesim dhe kur dhe si t'i shpërndajmë produktet. Vendimi i shitjes së një produkti ose blerjes së një faktori mund të ndahet nga vendimi prodhimit. Një fermer mund të ndajë shitjen e një produkti për të siguruar epërsitë e ndryshimit të çmimeve. Për drithërat dhe produktet e tjera që magazinohen, shitja e tyre mund të bëhet para fillimit të prodhimit, gjatë procesit të prodhimit dhe në korrje ose pas korrjes gjatë periudhës së magazinimit. Për shumicën e prodhimeve blegtorale dhe produkteve të tjera të cilat nuk mund të magazinohen, shitja mund të bëhet, para se të fillojë prodhimi, ose në momentin e prodhimit. Duke mos marrë parasysh llojin e produktit ose të faktorit ekzistojnë shumë mundësi për përcaktimin e kohës së shitjes. Shitja e drithit dhe produkteve blegtorale si dhe blerja e faktorëve përpara se të prodhohen ose në momentin e prodhimit është praktikisht më i arsyeshëm në sektorin bujqësor. Konsideratat kryesore që duhen marrë parasysh në shitjen e një produkti ose faktori para prodhimit ose në momentin e prodhimit kanë të bëjnë: Me ndryshimet e pritura në çmimet midis atij të përcaktuar për shitje dhe atij që mund të jetë i mundshëm në momentin e prodhimit. Me marrëveshjet financiare për të garantuar çmimin. Me riskun që shoqëron sasinë e prodhimeve të pritura dhe me riskun financiar që mund të shoqërojë fermën. Në qoftë se çmimet e faktorëve priten të rriten ose çmimet e produkteve priten të ulen në kohën e prodhimit dhe një çmim shumë më i favorshëm mund të sigurohet nga shitja ose blerja e mëparshme, atëherë do të ishte më e dëshirueshme shitja e mëparshme e një pjese të prodhimit dhe e blerjes së faktorëve. Në qoftë se për çmimet nuk priten ndryshime të rëndësishme në kohën e prodhimit, risku potencial i mundshëm i një rritje të papritur të çmimeve të faktorëve ose një rënie e çmimit të prodhimit mund të sugjerojë që shitja



e mëparshme të ishte më e dëshirueshme. Në qoftë se blerja e një faktori kërkon kryerjen e një operacioni financiar në formën e një parapagimi, atëherë këto kosto duhet të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të përfitimeve ekonomike të blerjeve të tjera alternative. Sigurisht, risku që shoqëron prodhimin e ardhshëm të shumë aktiviteteve duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të alternativave të shitjes së mëparshme. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të shitjes së produkteve. Zgjedhja e tregjeve për blerjen e inputeve dhe shitjen e produkteve varet nga kombimi i çmimit me shërbimet e ofruara. Transporti ndikon në përcaktimin e tregut të shitjes. Shitja me kredi nga tregtarët e faktorëve të tillë si fara, ushqimi, plehu dhe kimikate ashtu edhe makineri e pajisje mund të jetë e rëndësishme për disa fermerë. Shërbimet që ofrojnë blerësit e produkteve mund të jenë të rëndësishme në vendin se ku do të shiten produktet, disa blerës ofrojnë metoda të ndryshme blerje që përfshijnë blerjen me para ose me kontratë paraprake. Tre janë mënyrat kryesore për shitjen e një produkti: shitja me para në dorë në momentin e prodhimit, shitja pas magazinimit dhe shitja me anë të kontratimit të mëparshëm.

**Shitja me para në dorë në momentin e prodhimit**- është karakteristike për produktet blegtorale, frutat dhe perimet që prishen dhe nuk mund të magazinohen. Edhe pse shitja e këtyre produkteve bëhet vetëm në para, koha e shitjes është akoma e rëndësishme. Për disa produkte, ato blegtorale në veçanti, shitja mund të jetë më e dobishme në çdo ditë të javës. P.sh., qumështi shitet çdo ditë, ndërsa nënproduktet e tij mund të shiten edhe çdo javë.

**Shitja e produkteve të magazinueshme**-të tilla si drithërat, mundësitë e shitjes pas korrijës vlerësohen duke u krahasuar me çmimin sezonal që do të arrihet më pas, si dhe koston e magazinimit. Magazinimi nuk është gjithmonë një variant i mirë pasi çmimi në momentin e korrijës shpesh mund të jetë më i mirë se ai që pritët në të ardhmen. Në qoftë se ky i fundit përballon koston e magazinimit është më i preferueshëm. Disa fermerë për t'iu shmangur riskut të çmimit shpesh përdorin shitjen sipas një plani periodik. Kështu, p. sh., ato mund të shesin 1/4 e prodhimit çdo 3 muaj ose mund të shesin 1/12 çdo muaj. Shpërndarja e shitjeve në kohë redukton riskun e ndryshueshmërisë së çmimeve.

**Shitja me anë të kontratimit të mëparshëm**- përdoret për të siguruar avantazhin e çmimeve të favorshme që mund të ndodhin para se produkti të jetë prodhuar. Në të njëjtën kohë kjo mënyrë redukton riskun nga çmimi dhe garanton shitjen e prodhimit. Lidhja e kontratës për shitjen e prodhimit mund të shërbejë si garanci për huadhënësit. Kontratat për shitjen e produkteve ose blerjen e inputeve mund të jenë dy llojesh:

**Kontrata e mëparshme në para**-është një marrëveshje midis prodhuesit dhe tregtarit që konkretizon elementet e shitjes së ardhshme ose blerjen e një inputi.

**Kontrata e mëparshme me pagesë dhe shitje të mëvonshme**-të gjithë elementët e saj përcaktohen ekzaktësisht dhe prodhuesve u jepën disa mundësi se kur dhe si ata do të vendosin të shesin produktet.

### **Tema mësimore nr.3: Magazinimi i produkteve**

**Magazinat janë vende të rëndësishme në të cilën ruhen dhe administrohen mallra, lëndë të para, produkte të gatshme, inventarë, vegla pune, ambalazhe etj.** Sot, magazinat e shumë lëndëve të përdorshme që paraqesin rrezik për ndotjen e mjedisit ndërtohen sipas parametrave të përcaktuara me kujdes të veçantë brenda standardeve dhe kushteve teknike. Magazinimi në këtë rast nuk është thjeshtë një proces ekonomik, por ka edhe rëndësi shoqërore për popullsinë e zonës. Tashmë kuptohet se njeriu duke ruajtur mjedisin siguron vazhdimësinë e jetës dhe të ekzistencës. Magazinat klasifikohen sipas disa kriterëve ku më kryesoret janë: sipas objektit dhe sipas pronësisë.

**Magazinat sipas objektit** klasifikohen në tre grupe:

**Magazinat e mallrave ushqimore.** Kështu, magazinimi i produkteve mbështetet mbi baza ligjore të detyrueshme për të gjithë, duke vënë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e konsumatorit.

**Magazinat e mallrave industriale** janë dy llojesh magazina të lëndëve të para që shërbejnë për ruajtjen e lëndëve të para të produkteve e nënprodukteve me origjinë bimore e shtazore dhe magazina të produkteve të gatshme që shërbejnë për ruajtjen e produkteve të cilat blihen në një periudhë kohë kur çmimet janë më të ulta dhe që i qëndrojnë ruajtjes me qëllim që të shiten në një periudhë kur çmimi i tyre është më i lartë.

**Magazinat e mallrave me rrezikshmëri.** Mallrat e rezikshme, në qoftë se nuk magazinohen sipas kushteve të përcaktuara, paraqesin rrezikshmëri për mjedisin, faunën, florën dhe njerëzimin.

**Klasifikimi i magazinave sipas pronësisë** ka më shumë rëndësi nga këndvështrimi ekonomik i procesit të magazinimit. Këtu mund të veçojmë dy grupe: magazina në pronësi të përdoruesit do të thotë që pronari i mallrave të magazinuara është njëkohësisht edhe pronari i magazinës dhe magazina në përdorim të përdoruesit do të thotë që nuk janë në pronësi të tyre por e ka marrë me qira.

Funksionet e magazinave varen nga fakti se cilës fazë të qarkullimit ekonomik i shërbejnë e kujt i përkasin. Kështu, të tjera detyra zgjidhin magazinat e prodhimit, të tjera magazinat tregtare e të tjera magazinat e transportit. Funksionet e magazinave janë:

**Ruajtja e mallrave**-përdorimi me tipik i magazinave është mbajtja dhe ruajtja rezervë e produkteve. Magazinat sigurojnë mbrojtjen fizike nga dëmtimet e ndryshme të mallrave që mbahen rezervë gjithashtu ato kryejnë edhe një varg shërbimesh të tjera, si mbajtja e regjistrave kontabël, qarkullimi i stokut dhe riparimet etj., të cilat lidhen me çështje ekonomike të veprimtarisë së firmave.

**Përpunimi i mallrave në magazinë** - kupton dy forma: si vazhdim të procesit të prodhimit dhe si përgatitje e tyre për të lehtësuar transportin. Përpunimi i mallrave si vazhdim i procesit të prodhimit ka të bëjë me paketimin e ambalazhimit të tyre. Në magazina bëhet edhe grupimi dhe paketimi i mallrave për të lehtësuar lëvizjen e tyre dhe për të shfrytëzuar sa më mirë mjetin e transportit. Mënyrë tjetër është ndarja në sasi më të vogla e transporti ndërmjetës. Në të dyja rastet, magazina është pika e pajisur me forcë punëtore dhe pajisjet e nevojshme për të bërë ndarjen e produkteve në sasi më të vogla për t'i dërguar te konsumatori.

**Ambalazhimi dhe paketimi**-Ambalazhimi është përgatitja e mallit për shitje ose për konsum vetjak, kurse, paketimi është përgatitja e mallit për ruajtje ose për transport.

**Veprimet për furnizimin dhe kontrollin e mallrave gjatë hyrjes në magazinë** -dy janë konceptet që lidhen në këtë rast **furnitori** dhe **klienti**. Furnitori është subjekti që sjell mallra në magazinë. Për një magazinë furnitori është ai subjekt që i shet mallra asaj, kurse klient është subjekti që blen mallra nga magazina. Mbi këtë bazë logjike kemi bërë ndarjen në veprime të furnizimit e kontrollit të mallrave që hyjnë në magazinë dhe veprime të zbatimit të proceseve të klientëve.

**Kontrolli fizik dhe dokumentar**-është një nga elementët bazë të këtij operacioni. Për të realizuar kontrollin dokumentar, me ardhjen e mallit magazinieri duhet të marrë në dorë dokumentet që e shoqërojnë atë: faturën e furnitorit, policngarkesën e transportuesit, certifikatën e cilësisë së mallit, certifikatën e origjinës dhe fletë-paketimin. Fatura jep të dhëna të hollësishme për furnitorin: për llojin, sasinë, çmimin për njësi, dhe vlerën gjithsej të mallrave; për formën dhe kohën e pagesës, si dhe datën e prerjes së saj. Certifikata e cilësisë është dokument që shoqëron mallin dhe tregon karakteristikat dhe nivelin e cilësisë së tij. Fletëhyrja është një dokument ligjor që vërteton ekzistencën e mallrave në magazinë dhe përmban: numrin rendor dhe datën e prerjes, emrin e furnitorit e adresën e tij, artikullin, njësinë e matjes, sasinë, çmimin për njësi dhe vlerën

gjithsej, transportuesin, llojin e mjetit dhe targën e tij, firmën e magazinierit që e mori në dorëzim.

**Fletë-inventari** është dokumenti që përdoret për të kryer inventarizimin në magazina, njësi shitje e prodhimi në periudha të caktuara kohe ose në fund të periudhës. Inventari i kryer me përgjegjësi e saktësi krahason gjendjen e kontabilitetit me gjendjen në fakt.

**Fletë-inventari** i magazinës është një dokument i rëndësishëm që vërteton ligjërisht gjendjen e mallrave, inventarëve, lëndëve të para, produktet e gatshme etj., në fund të periudhës së ushtrimit, të vlerësuar me metodën e kostos mesatare të ponderuar; por sipas rastit mund të përdoret dhe metoda LIFO e FIFO. Ky dokument i bashkëlidhet dokumenteve përmbledhëse të kontabilitetit, bilancit të veprimtarisë së njësisë ekonomike. Magazinieri, dokumentet e hyrjes dhe të daljes i dorëzon në zyrën e financë-kontabilitetit me libër dorëzimi në afatet e caktuara, zakonisht çdo tre ditë dhe në fund të muajit, brenda datës 3 të muajit pasardhës, ose sipas datave të caktuara nga administratori ose i ngarkuari i tij.

#### **Tema mësimore 4: Shpenzimet në ferma**

*Shpenzimet janë kostot e të mirave të shitura nga ndërmarrja ose të shërbimeve të kryera prej saj gjatë procesit të realizimit të të ardhurave.* Këto shpenzime shërbejnë për të mbuluar nevojat kryesore të ndërmarrjes. Shembuj shpenzimesh janë: pagat e punonjësve, harxhimet e energjisë elektrike, ujit, shpenzime udhëtimi etj. Ato llogariten për fermën në tërësi, për çdo degë prodhimi dhe për çdo njësi të sipërfaqes. Për realizimin e veprimtarisë së saj në fermë realizohen shpenzime të cilat kanë të bëjnë me: pagesat e faturave për furnizim me lëndë të parë, materialin ndihmës, shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e telefonit, ujit, shpenzimet e qirasë etj. Këto janë veprime të zakonshme të çdo ferme, e cila zhvillon aktivitet ekonomik. Fermerët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari nëse nuk kanë mjete financiare. Secili fermer bën shpenzime pa marrë parasysh madhësinë e veprimtarisë të cilën kryen. **Me shpenzime prodhimi kuptojmë të gjitha shpenzimet që kryhen gjatë vitit për të realizuar produkte të caktuara, të cilat përbëjnë të ardhurat bruto të fermës** Ndërsa, **ndërmarrësia** nënkupton përpjekjet e fermerit që me iniciimin e veprimtarisë ekonomike të realizojë rezultate sa më të mira afariste, përkatësisht një fitim dhe dobi sa më të madhe. **Fitimi** është diferenca ndërmjet të dalave totale dhe të hyrave totale në një cikël ose periudhë llogaritare. Fermeri i realizon të ardhurat e veta me shitjen e efekteve, përkatësisht të prodhimeve të veta në treg. Me këto të ardhura ndërmarrësi do të përpiqet t'i mbulojë shpenzimet e bëra për prodhimin e këtyre produkteve dhe të realizojë një fitim sa më të madh. Shpenzimet përfaqësojnë tërësinë e sendeve materiale të konsumuara, të mjeteve monetare të paguara dhe të detyrimeve financiare të krijuara për arritjen e një qëllimi të paracaktuar prodhimi, shërbimi, investimi ose plotësim nevojash shoqërore. Në aspektin kuptimor ato duhet të dallohen nga harxhimet, të dalat dhe nga dhënit. **Harxhimet** janë shprehje natyrale që tregojnë sa elemente të ndryshme janë harxhuar në procesin e krijimit të efekteve: p.sh., sasia e lëndëve të para dhe e materialit të harxhuar, orët e punës etj. **Të dalat** janë harxhimi i përfshirë në efektet e shitura p.sh., vlera e blerjes së mallit të shitur ose shpenzimet e prodhimit të produkteve e shërbimeve të shitura. **Dhënit** janë të gjitha daljet e materialit, prodhimeve ose shërbimeve nga depoja, si dhe zvogëlimi i parasë në arkë ose në llogarinë e bankës. Llogaritja e këtyre shpenzimeve për fermën në tërësi dhe për çdo degë të saj mbështetet në rregjistrimet e bëra në inventar, në llogaritë bujqësore, në ditarin e arkëttimeve e pagesave dhe të debi-kredive. Disa të dhëna nga këto dokumente, merren ashtu siç janë dhe disa të tjera përpunohen. **Qiraja e tokës**, pronë e fermerit njihet edhe si qira e përlllogaritur. Ajo llogaritet duke shumëzuar vlerën e kësaj toke, sipas inventarit, me interesin e kredisë afatgjatë.

Qiraja për tokën e marrë nga të tjerët, e njohur edhe si qira e paguar, merret nga ditari i pagesave me karakter të përgjithshëm. **Shpërblimi i punës** së gjallë njerëzore merret nga llogaria bujqësore. Po kështu, kapitali i ndryshueshëm si, vlera e farave, plehrave kimike, insekticideve etj., merren nga llogaritë bujqësore. E njëjta procedurë ndiqet edhe për ushqimet e blera për blegtorinë, duke përfshirë këtu edhe pagesat për kullotje, si dhe për ushqimet e prodhuara nga vetë ferma. Në shpenzimet e ndryshueshme bëjnë pjesë karburantet dhe lubrifikantët e harxhuara për mekanikën e vet bujqësore. **Në shpenzimet e kapitalit** të pandryshueshëm në rradhë të parë bën pjesë amortizimi i llogaritur për veprat përmirësuese në shërbim të tokës, për ndërtesat, për kulturat drusore në prodhim, për kafshët dhe makineritë. Këtu përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracionet e disa prej mjeteve të lartpërmendura. Krahas tyre, llogaritet edhe interesi mbi kapitalin e ndryshueshëm dhe të pandryshueshëm, si për kapitalin e vet ashtu edhe për kapitalin e marrë hua, i cili është shpenzim për fermën. Interesi për kapitalin e vet të pandryshueshëm llogaritet duke u mbështetur në përqindjen e interesave të kredive afatshkurtra dhe në vlerën e këtij kapitali për sa kohë ai është zënë në degët e ndryshme të prodhimit. Ky interes nuk llogaritet për kafshët që paracaktohen për prodhim qumështi, vezë dhe për perimet, sepse produktet e tyre shndërrohen çdo ditë ose shumë shpejt në likuiditete. Për kapitalin e huaj të ndryshueshëm, interesi është ai që ka paguar ferma në Bankën Tregtare Agrare ose në institucionet e tjera kredituese. **Interesi** për kapitalin konstant llogaritet duke shumëzuar vlerën e çdo forme të këtij kapitali, me përqindjen e interesave të bankave. Llogaritja e shpenzimeve sipas fazave të procesit të prodhimit, për fermën në tërësi dhe për çdo degë të saj, nuk mund të paraqitet në një pasqyrë të vetme. Kjo sepse, fazat nuk janë të njëjta për të gjitha degët e prodhimit. Prandaj, llogaritja e shpenzimeve sipas fazave të procesit të prodhimit paraqitet në aq pasqyra sa janë edhe grupet e degëve të njëjta të fermës. Ka dy grupe të mëdha degësh homogjene, degët e prodhimit bujqësor dhe degët e prodhimit blegtoral. Për të plotësuar pasqyrën përkatëse, të dhënat nuk janë të gatshme, ndaj kërkohet përpunimi i tyre. Kështu, në **shpenzimet e mbjelljes** përfshihet shpërblimi i punës dhe shpenzimet e mekanikës bujqësore (karburanti, amortizimi, shpenzimet e mirëmbajtjes etj), pronë e vetë fermerit ose pagesa e bërë të tretëve, kur ajo është e tyre. Në këtë fazë përfshihen edhe farat e përdorura si dhe plehu kimik, që është përdorur si pleherim bazë etj. Në të njëjtën mënyrë, veprohet për të llogaritur shpenzimet edhe për fazat e tjera. Këto shpenzime llogariten jo vetëm në lekë, por edhe në përqindje. Kështu, përcaktohet shkalla e pjesëmarrjes së çdo faze në shpenzimet e prodhimit të çdo dege dhe për fermën në tërësi. Shpenzimet e prodhimit të këtyre degëve ndahen në përputhje me fazat e progresit të prodhimit. Kështu, shpenzimet për shpërblimin e punës përfshijnë shpërblimin për shërbimet që u kryhen kafshëve si dhe shpërblimin e punës që është hargjuar për ushqimet e prodhuara nga vetë ferma e të paracaktuara për këto kafshë. Kjo realizohet kur mbahen të dhëna analitike për ushqimet e sipërmendura. Në rast të kundërt, ato përfshihen në shpenzimet për ushqime bashkë me vlerën e ushqimeve të blera, me shumën e paguar për kullotje etj. Në të njëjtën mënyrë llogariten shpenzimet edhe për fazat e tjera të degëve të prodhimit blegtoral. Me interes për fermën është edhe grupimi i shpenzimeve të prodhimit në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. **Në shpenzimet e ndryshueshme** përfshihen të gjitha shpenzimet, që ndryshojnë në varësi të madhësisë së degës ose të vëllimit të prodhimit. **Në shpenzimet e pandryshueshme** përfshihen shpenzimet që nuk ndryshojnë për një nivel të caktuar veprimtarie. Shpenzimet e ndryshueshme të çdo dege prodhimi përbëhen nga shpërblimi i punës familjare dhe të huaj, pagesa për punimet e kryera nga të tretët, shpenzimet për farat, plehërat kimike, insekticidet dhe barnat, ushqimet e blera, shpenzimet për qiranë e kullotjes, karburantet dhe lubrifikantet për makineritë e vetë fermës, pagesat për ujtitje etj. Shpenzimet e ndryshueshme kanë lidhje të

drejtpërdrejtë me degët e prodhimit. Ato llogariten fillimisht për fermën në tërësi dhe më pas ndahen për çdo degë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Në raste të veçanta, kur një lloj kapitali i pandryshueshëm i shërben vetëm një dege prodhimi, atëherë shpenzimet e pandryshueshme që llogariten, nuk ndahen midis degëve të prodhimit por transferohen në degën përkatëse. Kështu, p.sh., amortizimi i një stalle që i shërben vetëm një lloji të gjësë së gjallë ose amortizimi i një sere në të cilën kultivohet vetëm një lloj perimesh etj. Klasifikim i shpenzimeve shërben për të gjetur çmimin më të vogël të shitjes kur dihet prodhimi ose për të përcaktuar prodhimin më të ulët të leverdishëm kur dihet çmimi i shitjes. Përcaktimi i çmimit më të vogël të shitjes ose i prodhimit minimal të leverdishëm, bëhet nëpërmjet formulës:  $K + v * x = c * x$ ; ku: **K**-tregon shpenzimet e pandryshueshme, **v**- shpenzimet e ndryshueshme për çdo njësi produkti, **c**-çmimin e shitjes për njësi produkti dhe **x**-sasia e produktit të prodhuar. **Me çmim më të vogël të favorshëm të një produkti** do të kuptojmë atë nivel çmimi, që mbulon shpenzimet e pandryshueshme dhe ato të ndryshueshme. **Me prodhim më të vogël të favorshëm** do të kuptohet niveli i prodhimit, poshtë të cilit nuk ka interes ekonomik për të prodhuar. Ferma nuk ka as fitim as humbje, pasi të ardhurat janë të barabarta me shpenzimet. Kjo quhet edhe pikë ekuilibri ose pikë kritike për fermën ose për një degë të saj. **Me shpenzime të përgjithshme** do të kuptohen shpenzimet, të cilat nuk i referohen një dege të caktuar të prodhimit bujqësor e blegtoral, por u shërbejnë shumë prej tyre njëkohësisht. Ato anë lidhur me disa lloje aktiveve të qëndrueshme. Në përgjithësi, nuk varen nga sasia e prodhimit të realizuar gjatë vitit kontabël. Në kategorinë e shpenzimeve të përgjithshme bëjnë pjesë amortizimi i këtyre aktiveve, shpenzimet për mirëmbajtje, siguracionet, % e interesit që llogaritet në disa prej tyre. Shpërndarja e këtyre shpenzimeve ndërmjet degëve të ndryshme të prodhimit bëhet me disa metoda, por asnjëra prej tyre nuk mund të ndajë me saktësi këto shpenzime. Metoda më e thjeshtë dhe më e përdorshme është ajo **që mbështetet në të ardhurat bruto të fermës**. Sipas kësaj metode, shpenzimet e përgjithshme ndahen ndërmjet degëve të prodhimit në varësi me peshën specifike që zënë të ardhurat bruto të çdo dege ndaj të ardhurave bruto të fermës. Kështu p.sh., nëse të ardhurat bruto nga kultura e grurit zënë 20% të të ardhurave bruto të fermës, atëherë kjo degë do të ngarkohet edhe me 20% të shpenzimeve të përgjithshme. Metodë tjetër që mund të përdoret për ndarjen e shpenzimeve të përgjithshme, është **metoda që mbështetet në fitimin bruto**. Mënyra ose rruga për të ndarë këto shpenzime është e njëjtë. Kjo metode nuk përdoret kur ka degë prodhimi që dalin me humbje. Një tjetër metodë është ajo **që mbështetet në hapësirën që zihet nga çdo degë prodhimi** në lidhje me një element pasuror që u shërben disa degëve të prodhimit. Kështu p.sh., shpenzimet vjetore të një stalle që u shërben lopëve dhe viçave, do të ndahen ndërmjet këtyre dy degëve në varësi me hapësirën e paracaktuar për secilën prej tyre. Kjo metodë përdoret edhe në rastin e tokave të marra me qira. Qiraja e tokës ndahet ndërmjet degëve të ndryshme të prodhimit në varësi me % e kësaj toke, që është zënë nga secila dege. Qëllimi kryesor i ekonomisë së fermave nuk është sigurimi i fitimit maksimal nga një degë e caktuar, por shfrytëzimi me efektivitet i faktorëve dhe mjeteve të prodhimit nëpërmjet kombinimit të atyre degëve, që të sigurohet një fitim sa më i madh për fermën në tërësi. **Tatimi mbi vlerën e shtuar është tatim mbi konsumin**. Ai zbatohet për të githa furnizimet e të mirave (mallrave) dhe shërbimeve të kryera nga personat fizikë ose juridikë, që zhvillojnë veprimtari ekonomike në territorin e një vendi. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në ha, në pronësi të tatimpaguesit. Pronësia e këtyre tokave bujqësore përcaktohet në dokumentet që e vërtetojnë atë. Këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nënkategoritë për çdo kategori minimale të tokës bujqësore. Niveli i taksës përcaktohet në lekë/ha. Detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar normën e taksës me bazën e tatueshme. **Legjislacioni tatimor**-Regjimi tatimor në

Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një paketë ligjesh, direktivash, rregulloresh, marrëveshesh tatimore me vendet e tjera, të cilat paraqesin një përmbledhje të plotë të të gjitha llojeve, niveleve, llogaritjeve, procedurave, si dhe metodave e formave të kontrollit tatimor për taksat, tarifat dhe tatimet që përfshin sistemi tatimor shqiptar. Legjislacioni tatimor u nënshtrohet amendimeve dhe ndryshimeve të vazhdueshme, për shkak të zhvillimeve të shpejta të ekonomisë. **Shkalla tatimor**-Personat juridik dhe fizik në Republikën e Shqipërisë janë subjekt i tatimeve. **Tatimi mbi fitimin** -Të gjitha kompanitë të huaja ose jo, që janë të regjistruara në regjistrin tregtar dhe paguajnë TVSH, janë subjekt i tatimit mbi fitimin. Tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit vetëm për të ardhurat e gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dokumentet bazë që përdoren për të justifikuar shpenzimet për efekt tatimor janë: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe lëshuar në përputhje me udhëzimet e ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor. **Tatimi mbi vlerën e shtuar**-TVSH paguhet për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të realizuara kundrejt pagesës nga personi i tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pragu i TVSH-së për regjistrim është **5 milionë lekë** çdo vit për xhiron vjetore të biznesit. Të gjithë personat fizik dhe juridik të përfshirë në aktivitetet e eksportit apo importit, janë të detyruar të regjistrohen, në mënyrë që të paguajnë TVSH-në. Çdo subjekt tjetër i tillë si: individët, njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat shoqërore, politike dhe ndërkombëtare, misionet diplomatike etj., të cilat kryejnë veprimtari import-eksporti, pavarësisht nga xhiroja janë gjithashtu të detyruara të regjistrohen. Për çdo subjekt që ushtron veprimtarinë e import-eksportit, operacionet doganore do të vazhdojnë pasi ai të dorëzojë origjinalin ose kopje të noterizuar të Certifikatës së Numrit të Identifikimit për Personin e Tatueshëm (NIPT). Xhiroja e përgjithshme vjetore llogaritet në bazë të çmimit total të paguar nga blerësi dhe përfshin taksat e gjobat. Deklarimi i TVSH-së dhe formulari i pagesës plotësohen në dy kopje dhe personi i tatueshëm e paraqet atë në bankën përkatëse me të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka një marrëveshje në lidhje me pranimin e pagesave të TVSH-së, brenda 14 ditëve pas përfundimit të periudhës tatimore. TVSH-ja zbatohet në masën 20%, me përjashtim të furnizimit të barnave dhe shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike e private, të cilat taten me një normë prej 10%. Veprimet që përjashtohen nga pagesa e TVSH-së janë: furnizimi me shërbime financiare, furnizimi me ar, kartëmonedha apo monedha të BSh, furnizimi me pulla postare, të cilat përdoren për shërbimin e postës ose pulla të ngjashme, furnizimi i tokës dhe marrja me qira e saj është furnizim i përjashtuar, përveçse kur toka përdoret për parkim apo si garazh për automjetet dhe mjetet e tjera të lëvizshme. Teknikisht llogaritja e TVSH në fermë ndjek dy faza: **arë** lidhet me llogaritjen e TVSH për blerjet që realizon ndërmarrja dhe kjo quhet TVSH e zbritshme. **Faza e dytë** lidhet me llogaritjen e TVSH për shitjet që realizon ndërmarrja dhe kjo quhet TVSH e mbledhshme e që më pas ndërmarrja ia paguan shtetit. Diferenca ndërmjet tatimit të pagueshëm dhe tatimit të zbritshëm jep shumën e TVSH, që duhet të derdhet në buxhetin e shtetit. Kështu p.sh., në qoftë se një ndërmarrje blen mallra dhe vlera e tatueshme e tyre në castin e blerjes është 100 000 lekë dhe TVSH është 10%, atëherë TVSH e zbritshme është 10 000 lekë. Ta zëmë gjithashtu se, ndërmarrja i shiti të gjitha këto mallra, vlerësuar me çmimin e shitjes 140 000 leke. Atëherë, TVSH i pagueshëm, është  $140\,000 \times 10\% = 14\,000$  lekë. Shuma e TVSH, që i duhet paguar buxhetit të shtetit është  $14\,000 - 10\,000 = 4\,000$  lekë, kjo shumë del edhe duke llogaritur vlerën e shtuar dhe duke e shumëzuar me përqindjen e TVSH. Në rastin konkret,  $140\,000 - 100\,000 \times 10\% = 4\,000$  lekë. Për të llogaritur dhe dokumentuar TVSH si dokument justifikues shërben

fatura tatimore, e cila në çdo rast plotësohet nga shitësi i mallit dhe ka këtë formë. Fatura plotësohet në dy kopje, ku origjinali i dërgohet blerësit dhe shërben si dokument bazë, për të justifikuar shumën e TVSH-së së zbritshme. Kopja e dytë mbahet nga shitësi, mbi bazën e së cilës ai llogarit dhe pasqyron TVSH e pagueshme, i cili aktualisht është 10% dhe quhet shkalla tatimore. Për eksportet **NUK** paguhet TVSH. Për të llogaritur dhe rregjistruar TVSH, është e detyrueshme, që çdo person fizik apo juridik i tatueshëm, të mbajë dy libra: librin e blerjeve dhe librin e shitjes. Libri i blerjeve plotësohet çdo ditë. Për çdo rast blerjeje, në të rregjistrohen: data dhe numri i faturës së shitësit kur ai është vendas, data dhe numri i deklaratës tatimore kur blihet nga importi, emri i shitësit si dhe NIPT-i i tij. Shuma e blerjes duke përfshirë edhe TVSH.

### **Tema mësimore nr.5: Dokumentimi i shpenzimeve në ferma**

Dokumentimi i shpenzimeve është domosdoshmëri, pasi me anë të tij merret informacion dhe bëhen analiza me qëllim marrjen e vendimeve sa më efektive. Për dokumentimin e shpenzimeve fermat përdorin *sistemin kontabël*. Me anë të këtij sistemi realizohen qëllimet e tij, kur ai ndërtohet në mënyrë të tillë që me anë të rregjistrimeve, të ndiqen sistematikisht, ato veprimtari të fermës që kanë rëndësi më të madhe ekonomike. Dokumentimi dhe rregjistrimi i shpenzimeve në fermën është një detyrim dhe mbahet sipas legjislacionit tatimor. Krijimi dhe mbajtja e dokumentacionit jo në rregull shkakton efekte negative në aktivitetin biznesor, pasi nuk jep mundësinë e një analize të saktë në fund të periudhës biznesore. Kjo kërkon egzistencën e një “sistemi llogarish”, fleksibël, sigurisht pa shkelur parimet kryesore kontabël. Në ferma njihen dy sisteme kontabël: *Sistemi kontabël i ndërvarur të fermave* - Sistemet e ndërvarura që përdoren në ferma janë: sistemi klasik dhe sistemi Ditar-Libër i madh. Nëpërmjet tij bëhet e mundur ndjekja kontabël e fermës jo vetëm në tërësi por edhe për çdo degë prodhimi në veçanti. Përdorimi i këtij sistemi është i lidhur me një vit të plotë kalendarik dhe jo me planin e prodhimit që zhvillon ferma. *Sistemi i avancuar i llogarive bujqësore* - u konceptua në mënyrë të tillë që çdo regjistrim kontabël të ketë vendin e vet si dhe të realizohen qëllimet e kontabilitetit. Qëllimi i ndërtimit të këtij sistemi është të sigurojë ndjekjen e plotë kontabël dhe analizën tekniko-ekonomike të fermës, furnizimin me të dhëna tekniko-ekonomike për përdorimin e metodave bashkëkohore të organizimit dhe riorganizimit të fermave. Sistemi i përdorur bazohet kryesisht në parimet e rregjistrimit të thjeshtë, por me shumë përmirësime. Këto përmirësime mbështeten në njohjen e thellë të strukturës, organizimit dhe funksionimit të fermave, në familjarizimin që ka egzistuar me llogaritë dhe rregjistrimet bujqësore, si dhe me përvojën e fituar nga përdorimi i kontabilitetit në bujqësi në vende të ndryshme. Drejtimit kryesore të këtij sistemi janë ndjekja kontabël e përcaktimi i rezultatit ekonomik që bëhet duke u mbështetur në planin e prodhimit të fermës, inventari i aktiveve qarkulluese që lidhet me planin e prodhimit të fermës. Në të nuk përfshihen produkte ose inpute etj, të cilat nuk kanë lidhje me këtë plan. Viti kontabël fillon me procesin e parë të degës së parë dhe mbaron me procesin e fundit të degës së fundit të planit të prodhimit të fermës. Ndjekja kontabël e fermës në tërësi ose e çdo dege prodhimi realizohet kryesisht me anë të librit të “llogarive bujqësore”. Ky libër përmban regjistrimet e të dhënave teknike dhe ekonomike dhe shoqërohet me disa libra të tjerë. Mbajtja e llogarive bujqësore është e domosdoshme për ndjekjen sistematike dhe analizën tekniko-ekonomike të fermës. Llogaritë bujqësore janë një tërësi rregjistrimesh që kanë të bëjnë me funksionimin e degëve të ndryshme dhe me mjetet e prodhimit të fermës. Llogaritë shërbejnë në dokumentimin e shpenzimeve bujqësore. Ato kanë rëndësi sepse përcaktohet rezultati ekonomik i realizuar për fermën në tërësi dhe për çdo degë të saj në veçanti, përcaktohen shkaqet që kanë ndikuar në këtë rezultat; Ndihmon në riorganizimin e mundshëm të saj ose të degëve të veçanta, llogaritet kostoja

e prodhimit e përcaktohet raporti ndërmjet produktit të prodhuar e faktorëve, merren informacion i hollësishëm për nivelin e rentabilitetit tekniko-ekonomik të çdo dege prodhimi. Kjo, sepse nëpërmjet tyre llogariten rendimenti i qumështit për çdo kokë, numri i vezëve, prodhimi i mishit, prodhimi për dynym etj.; Argumentohet siguria e kthimit të kredive që mund të kërkohen nga bankat. Kredia e siguruar duhet të përdoret në ato degë të prodhimit ku sigurohet një rentabilitet më i lartë. Llogaritë bujqësore mund të klasifikojmë në:

“Llogari kryesore ose përfundimtare”, ku përfshihen të gjitha llogaritë që kanë të bëjnë me degët e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, d.m.th të gjitha degët prodhuese të saj. “Llogari ndihmëse ose ndërmjetëse”, ku përfshihen llogaritë e mjeteve të prodhimit, si makineritë, kafshët e punës si dhe arkëtimet e pagesat me karakter të përgjithshëm, kreditorët dhe debitorët. Në këtë grup llogarish përfshihen edhe disa degë të prodhimit bujqësor, të cilat shërbejnë vetëm për funksionimin normal të disa degëve kryesore, siç janë foragjeret për blegtorinë. Llogaritë “ndihmëse ose ndërmjetëse” lehtësojnë ndjekjen tekniko-ekonomike të llogarive kryesore ose përfundimtare. Numri dhe kategoritë e llogarive të një ferme varen nga tipi i prodhimit të saj dhe niveli i analizës së kërkuar. Kështu, p.sh fermat bujqësore jo mikse kërkojnë një numër më të vogël llogarish në krahasim me fermat mikse të prodhimit. Gjithashtu, kur kërkohet një analizë shumë e hollësishme e fermës, kjo parashikon edhe mbajtjen e shumë llogarive të veçanta dhe analitike “Llogari të përgjithshme” të cilat kanë lidhje sa me fermën aq dhe me familjen. Këtu përfshihen shpenzimet për automjetin, shpenzimet për energjinë elektrike, shpenzimet telefonike etj., kur ato shpenzohen edhe për nevojat të fermës dhe të familjes. ***Me rregjistrime bujqësore do të kuptohet paraqitja e të dhënave të një veprimi të caktuar në një llogari analitike ose sintetike.*** Nëpërmjet tyre sigurohet informacioni i nevojshëm për çdo veprim dhe për të gjitha fazat e procesit të prodhimit të çdo dege dhe për fermën në tërësi. Fermat e mëdha dhe ato të specializuara, të cilat kanë zyrë llogarie bëjnë çdo ditë rregjistrime të hollësishme të veprimeve që kryhen. Ndërsa fermat e vogla dhe me shumë degë prodhimi të paspecializuara, siç janë dhe pjesa më e madhe e fermave bujqësore në Shqipëri, nuk kanë nevojë dhe është e pamundur të mbahen rregjistrime të hollësishme për të gjitha degët e prodhimit. Këto rregjistrime bëhen për evidentimin e kohës që kërkohet për të realizuar procese të ndryshme pune, për sasinë e materialeve të përdorura, për sasinë e prodhimeve të realizuara nga çdo dege prodhimi. Ato janë kryesore për të matur efektivitetin dhe rentabilitetin e fermës, për riorganizimin e saj si dhe për marrjen e vendimeve të tjera. Rregjistrimet e të dhënave teknike për punën e gjallë pasqyrojnë orët e punës, që janë shpenzuar për të realizuar çdo proces prodhimi sipas degëve të veçanta. Rregjistrimi i të dhënave teknike për materialet tregon sasinë e materialeve të përdorura për çdo kulturë ose lloj të gjësë së gjallë, si: sasia e farave, plehrave kimike, herbicideve, uji etj., të cilat janë përdorur për kulturat bujqësore. Gjithashtu, rregjistrohen dhe sasinë e ushqimeve të thata, të njoma e koncentrate të konsumuara nga blegtoria, barnat e ndryshme etj. Në të dhënat teknike përfshihen edhe sasinë e prodhimit të marra nga bimët ose kafshët dhe që mund të shprehen në njësitë matëse të peshës, si kg, ton, ose në copë, numër etj. Të dhënat ekonomike që rregjistrohen janë: shpenzimet e kryera nga përdorimi i faktorëve të ndryshëm të prodhimit sipas degëve të veçanta, vlera e produktit të prodhuar nga këto degë, shpenzimet për punën e gjallë, pra, shpenzimet për pagat që u janë paguar punëtorëve të jashtëm dhe për pagat e llogaritura, kur puna kryhet nga anëtarët e familjes. Këto rregjistrime kanë të bëjnë me shpenzimet ose koston e materialeve të përdorura. Ato sigurohen nga blerjet në treg, si fara, plehra kimike, insecticide, ujë, energji elektrike, ushqime për blegtorinë, karburante dhe lubrifikante për nevojat e mekanikës si dhe të vetë fermës. Së fundi, rregjistrohen çmimet e shitjes dhe vlera e produkteve bujqësore e blegtorale të shitura ose të paracaktuara për shitje, të cilat prodhuar në ferma. Para se të fillojë



rregjistrimi dhe dokumentimi i të dhënave në një fermë duhet të sqarohet kuptimi i vitit kontabël dhe mënyra e përcaktimit të tij. Përcaktimi i drejtë i vitit kontabël lidhet me paraqitjen reale ose joreale të efektivitetit të fermave që ndiqen në mënyre kontabël. Me **vit kontabël** kuptohet periudha kohore ndërmjet dy inventarëve të njëpasnjëshëm gjatë ndjekjes kontabël të një ferme. Kjo periudhë mund të jetë e barabartë me një vit të plotë ose jo. Kur periudha është e barabartë me një vit të plotë kalendarik, atëherë data e fillimit të ndjekjes kontabël nuk paraqet interes të drejtpërdrejtë, por kohëzgjatja e vitit kontabël. Një mënyrë tjetër për përcaktimin e vitit kontabël mbështetet në kohëzgjatjen e një procesi të plotë prodhimi të fermës. Kjo kohëzgjatje varet nga plani i prodhimit të fermës, nga tipi i prodhimit të saj, p.sh., kur viti kontabël me ndjekjen tekniko-ekonomike të drithrave dimërore dhe në planin e prodhimit të fermës përfshihen edhe kulturat pranverore atëherë ai mbyllet kur magazinohet prodhimi i kulturave pranverore. Kur viti kontabël fillon me kulturat pranverore, atëherë ky vit mbyllet kur përfundon magazinimi i kulturave dimërore, në qoftë se ato janë përfshirë në planin e prodhimit të fermës. Në rast se në planin e prodhimit të fermës janë përfshirë edhe degë prodhimi me cikël afatgjatë, siç janë kafshët në rritje, atëherë fundi i vitit kontabël për to do të jetë ai që është për degët e tjera të prodhimit përcaktuar si më sipër. Kjo mënyrë e përcaktimit të vitit kontabël u përgjigjet më mirë qëllimeve të kontabilitetit bashkëkohor të fermave. Për dokumentimin e shpenzimeve në fermën bujqësore është e nevojshme të jepet kuptimi, përmbajtja dhe mënyrat e dokumentimit kontabël. *Evidencat kontabël dokumentojnë dhe evidentojnë veprimtarinë e fermave bujqësore.* Ajo fillon me rregjistrimin e inventarit të elementëve pasurorë, vazhdon me mbajtjen e llogarive të degëve dhe mjeteve të prodhimit dhe përfundon me llogaritjen e rezultatit ekonomik të realizuar. Dokumentimi dhe ndjekja kontabël e fermës mund të bëhet për fermën në tërësi, për grup degësh të njëjta ose veçmas, për çdo degë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Ky dokumentim shpenzimesh mund të shkojë dhe më tej, deri për çdo **varietet, racë, parcelë** dhe për çdo **kafshë**. Evidencat kontabël të dokumentimit në fermë dhe të dhënat e rregjistruara në to janë të rëndësishme. Në përputhje me nivelin e analizës tekniko-ekonomike që synohet, ka tri mënyra për ndjekjen kontabël të një ferme:

*Ndjekja kontabël e një ferme si një tërësi e vetme ose e pandarë.* Kjo mënyrë ndjekjeje kërkohet një sistem llogarish dhe rregjistrimesh, ku të behet: rregjistrimi i punës së gjallë të anëtarëve të familjes dhe jo të familjes të kryer në fermë, në orë dhe në lekë, rregjistrimi i punës së makinerive e kafshëve të punës të vetë fermës ose të të tretëve, në orë dhe në lekë, rregjistrimi i farave, plehrave kimike, kimikateve, ushqimeve për blegtorinë etj., në sasi dhe në lekë. Mbi bazën e këtyre të dhënave si dhe të disa arkëtim-pagesave dhe debi-kredive bëhet e mundur llogaritja e të ardhurave bruto, e shpenzimeve të prodhimit dhe e formave të ndryshme të rezultatit ekonomik për fermën në tërësi.

*Ndjekja kontabël e fermës sipas degëve të njëjta, të prodhimit.* Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një sistemi llogarish e rregjistrimesh, i njëjtë me atë të fermës si një e vetme, por duke përdorur një llogari për çdo grup degësh të njëjtë. Kështu hapen aq llogari sa janë edhe grup degët e njëjta. Dy grupe të mëdha degësh të njëjta janë prodhimi bujqësor dhe prodhimi blegtoral. Ato ndahen edhe në bimët e arave, perime, fruta etj., kur flasim për prodhimin bujqësor dhe: gjedh, dhen, dhi, derra, shpend etj., kur flasim për prodhimin blegtoral. Me këto llogari nuk mund të përcaktohen saktë tregues tekniko-ekonomik për çdo degë të prodhimit. Kjo mënyrë e dokumentimit jep një pamje të përgjithshme të efektivitetit të grup degëve homogjene. Ajo zakonisht, përdoret në fermat mikse të prodhimit, pra në fermat e paspecializuara në një drejtim të caktuar.

*Ndjekja kontabël e fermës sipas degëve të prodhimit.* Kjo mënyrë kërkon hapjen e llogarive për çdo degë të prodhimit veçmas. Ndjekja kontabël e fermës sipas degëve të prodhimit kërkon

evidentimin dhe llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo kulturë dhe për çdo lloj të gjësë së gjallë. Ajo synon në përcaktimin e degëve më fitimprurëse që mund të zhvillojë ferma. Më konkretisht, nëpërmjet kësaj mënyre të ndjekjes kontabël bëhet e mundur llogaritja e: *efektivitetit të çdo dege të prodhimit dhe e kontributit të saj në efektivitetin e përgjithshëm të fermës, faktorëve të prodhimit që janë hargjuar për çdo dynym ose për çdo kokë të gjësë së gjallë, prodhimitarisë së faktorëve të hargjuar për çdo degë të fermës.* Këta tregues përcaktojnë pozicionin e çdo dege të prodhimit në fermë dhe i japin mundësi fermerit për një oraganizim sa më të mirë të saj nga pikpamja e struktues së degëve të prodhimit. Me këtë metodë, ka mundësi që për çdo degë, që nuk paraqesin interes të veçantë ekonomik për fermën, mund të mbahet një llogari, si një degë prodhimi e përbashkët. Këto degë, zhvillohen në fermë kryesisht për mbulimin e nevojave familjare me disa produkte. *Me inventar kuptojmë tërësinë e veprimeve nëpërmjet të cilave realizohet klasifikimi sistematik i elementeve pasuror të fermës, matja dhe dokumentimi (rregjistrimi) i tyre në sasi dhe në vlerë.* Pas inventarizimit dhe vlerësimit të çdo elementi pasuror, është e domosdoshme të kalohet në grupimin dhe paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të inventarit. Në këtë mënyrë bëhet i mundur përcaktimi i shumës së aktivitetit, të detyrimeve ndaj të tretëve dhe pasurisë neto, si dhe shkallës së pjesëmarrjes së çdo grupi elementesh pasuror në përbërjen e aktivitetit. Realisht nëpërmjet paraqitjes përmbledhëse krijohet edhe një ide e plotë për burimet e financimit të aktivitetit, d.m.th. përqindja e kontributit të pasurisë neto dhe e burimeve të huajtura. Shkalla e pjesëmarrjes së pasurisë neto dhe e burimeve të huajtura në financimin e aktivitetit, varet nga tipi i prodhimit të fermës dhe nga qëndrimi i çdo ferme konkrete. Një fermer i mirë, për një ecuri normale të fermës dhe për të pasur më shumë siguri synon të mbulojë me kapitalin e veta mbi 50% të aktivitetit. Ai duhet të synojë gjithashtu që mjetet monetare të jenë më të mëdha se detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve që mund të jenë persona juridikë ose fizikë. Sipas mënyrës së realizimit të tij inventari **fizik ose ekstrakontabël** që realizohet duke matur konkretisht të gjithë elementet pasuror të fermës. **I brendshëm ose kontabël që** mbështetet në tepricat që paraqesin librat e ndryshëm kontabël. Por, të dhënat e këtij inventari mund të mos jenë plotësisht të sakta ngaqë gjatë regjistrimeve mund të jenë bërë gabime, në firot që pësojnë elementë të veçanta pasurorë etj. Për këtë arsye inventari kontabël kufizohet vetëm në disa elementë pasuror jolëndorë, siç mund të jenë debitorët, kreditorët etj. Elementë pasuror të inventarëve në ferma në ferma janë: toka bujqësore, rrjet ujitës, ndërtesa, kultura drusore, makineri dhe vegla, produkte të pashitura (gatshme), fara në depo, shuma për tu arkëtuar nga të tretët, mjete monetare, detyrime ndaj bankave, detyrime ndaj furnitoreve etj. Siç është theksuar më lart, në fermën bujqësore kemi dy grupe të mëdha degësh homogjene: degët e prodhimit bujqësor dhe degët e prodhimit blegtoral. Mbajtja dhe dokumentimi i shpenzimeve, në secilën degë përbën një moment të rëndësishëm, për të ndjekur ecurinë ekonomike të fermës dhe për të bërë analizën tekniko-ekonomike të saj. Pas kryerjes së inventarizimit dhe përcaktimit të vlerës së elementeve pasuror, fillon dokumentimi i veprimtarive që kryhen në fermë. Kjo kërkon hapjen dhe mbajtjen e llogarive për degët e prodhimit bimor, shtazor si dhe disa llogari të tjera. Nga pikpamja kontabël degët e prodhimit bimor ndahen në: *degë të thjeshta dhe degë të përbëra.* Me degë të thjeshta të prodhimit bimor kuptojmë të gjitha ato kultura nga të cilat sigurohet ose merret vetëm një lloj produkti, si p.sh., pambuku. Degë të përbëra quhen ato kultura nga të cilat merret më shumë se një lloj produkti, si p.sh. nga kultura e grurit merret kokrra e grurit si dhe kashta. Puna e gjallë shprehet në orë dhe në lekë. Në rastin e punëtorëve të huaj, nuk paraqet asnjë vështirësi, pasi rregjistrohet shuma që u është paguar atyre. Kur puna kryhet nga anëtarët e familjes, të cilët “nuk”, paguhen në shtyllën përkatëse të ditarit, rregjistrohen orët e kryera prej tyre dhe shuma e pagës llogaritet duke shumëzuar këto orë me tarifën mesatare të paguar

punëtorëve të huaj në fermë ose në zonën ku ajo bën pjesë, sipas llojit të punimeve të kryera. Për makineritë dhe kafshët e të tretëve, regjistrohen vetëm shumat e paguara atyre, kurse për ato të vetë fermës regjistrohen vetëm orët e punës të realizuara prej tyre. Përsa u përket materialeve të konsumuara (inputeve), si p.sh. fara, plehra kimik, insecticide etj. Regjistrohen në sasi dhe në vlerë në shtyllën përkatëse, kurse lloji i tyre pasqyrohet në shtyllën e dytë. Prodhimi i realizuar dhe vlera e tij regjistrohen në dy shtyllat e fundit të kësaj pasqyre. Shtylla e veçantë për regjistrimin e vlerës dhe tërthorazi të çmimit të shitjes (pjesëtimi i vlerës me sasinë jep çmimin), ka rëndësi për ato produkte që çmimi i tyre është në varësi të kohës. Të tilla në përgjithësi janë frutat dhe perimet. Dokumentimi kontabël i fermës sipas degëve të prodhimit nuk do të thotë mbajtja detyruesisht e llogarive të veçanta për çdo kulturë. Kjo është e nevojshme vetëm për kulturat që zënë peshën më të madhe të prodhimit. Për degët e tjera, ato mund të ndiqen në mënyrë kontabël të gjitha së bashku, duke i quajtur si një kulturë e vetme. Edhe degët e prodhimit, nga pikpamja e dokumentimit, ndahen në degë të thjeshta dhe të përbëra. Në degët e thjeshta të prodhimit përfshihen ato lloje të gjësë së gjallë nga të cilat sigurohet një produkt i vetëm, si vëçat, derrat dhe shpendët për mish etj. Për degët e përbëra janë ato lloje të gjësë së gjallë nga të cilat merren më shumë se një lloj produkti si, lopët nga të cilat merret qumësht dhe vëçat, dhentë dhe dhinë nga të cilat merret qumësht, qingja ose keca, lesh etj. Qëllimi kryesor i dokumentimit të shpenzimeve të degëve të veçanta të prodhimit shtazor, në radhë të parë, është përcaktimi i llojit dhe llogaritja e sasisë së çdo ushqimi. Kjo, sepse të ushqyerit, është element kryesor i kostos së prodhimit blegtoral. Ai zë 50-60 % të shpenzimeve për kafshët e riprodhimit dhe 70-80 % të kafshëve për mish. Për ushqimet, duhet sqaruar se, në llogarinë përkatëse regjistrohen vetëm lloji dhe sasia, sepse vlera e tyre gjendet në inventarin e hyrjeve dhe në llogaritë përkatëse të pagesave dhe detyrimeve. Ushqimet e prodhuara nga vetë ferma vlerësohen me koston e prodhimit të tyre, dhe në mungesë të tij, me çmimin e shitjes në treg. Për punën e gjallë, veprohet njëllor sikurse me degët e prodhimit bujqësor, por me të vetmin ndryshim se ajo nuk llogaritet çdo ditë, por në periudha më të gjata, zakonisht 10-15 ditore, kur vërehen ndryshime në proceset e punës që kryhen nga blegtorët. Për produktet blegtorale të prodhuara, bëhet rregjistrimi për çdo lloj produkti dhe drejtimi të tij, sa për treg, sa për konsum familjar dhe sa për degët e tjera brenda fermës. Për këto produkte shënohet sasia dhe cilësia e tyre. Për të llogariur sasinë e mishit të prodhuar është e nevojshme të zotërohen të dhënat e dy inventarëve, në fillim dhe në fund të vitit dhe të bëhet rregjistrimi i saktë i peshës së gjallë ose peshës së therur të kafshëve të dala nga ferma, si dhe atyre të hyra në fermë. Për të llogaritur treguesit e prodhimit dhe të efektivitetit është e domosdoshme të llogaritet numri mesatar i kafshëve gjatë vitit. Kjo kërkon regjistrimin sistematik të të gjitha ndryshimeve të ndodhura në një llogari bujqësore, p.sh., supozojmë që numri i lopëve të qumështit në fillim të vitit ishte 10 krerë. 3 prej tyre u shitën pas 4 muajve, 1 ngordhi pas 6 muajve dhe katër mëshqerra kaluan në kategorinë e lopëve më 1.10 dhe 1 u ble pas 6 muajve, atëherë numri mesatar i lopëve do të jetë 9. Për dokumentimin e shpenzimeve në degën e prodhimit shtazor, përdoren dokumentet justifikuese të cilët vertetojnë veprimin e kryer dhe ruhen në arkivin e fermës, për llogari të kontroleve të brendshme dhe të jashtëme të fermës. Të tilla janë: fletë hyrjet dhe fletë daljet, mandat arkëtimet mandat pagesat, urdhër xhirimet, çeku, kambialet etj. Për të pasur një informacion sa më të plotë mbi shpenzimet e kryera në fermën bujqësore, me qëllim mbajtjen e plotë të kontabilitetit, është e nevojshme të dokumentohen edhe llogaritë për mekanikën bujqësore, kafshët e punës si dhe disa llogari të tjera të natyrës së përgjithshme. Për shpenzimet në mekanikën bujqësore është e nevojshme të mbahet një llogari më vete ku çdo ditë të paraqitet lloji i punimeve dhe orët e punës, për çdo degë të prodhimit, për qëllime familjare dhe për punimet e kryera të të tretët. Në

këtë mënyrë, bëhet e mundur që në fund të procesit të prodhimit, të dihet puna e kryer nga çdo lloj makinerie, për çdo degë të prodhimit të fermës. Kjo mënyrë, mënjanon rregjistrimin e punës së kryer me mjetet e veta mekanike në llogaritë e degëve të prodhimit bujqësor. Por, krahas me rregjistrimin e punës së kryer, është e nevojshme të llogaritet sasia dhe vlera e karburanteve dhe lubrifikanteve të shpenzuara. Duke qenë se, rregjistrimi ditor i konsumit të tyre për çdo proces pune është i vështirë ndiqet një metodë praktike, sipas së cilës, bëhet rregjistrimi i tyre në ditarin e debi-kredive ose të arkëtimit pagesave sa herë që ato merren në pikat e furnizimit të karburanteve dhe lubrifikanteve. Në fund të vitit ato mbahen në ngarkim të degëve të prodhimit në raport me volumin e punës së kryer nga mekanika për secilën prej tyre. Për fermat që kanë kafshë pune mbahen dy llogari. Njëra ka pak a shumë formën e llogarisë së mekanikës bujqësore dhe në to do të rregjistrohet puna e kryer. Në llogarinë tjetër regjistrohen çdo ditë, sasi të ushqimeve të konsumuara prej kafshëve të punës, sipas llojit të ushqimeve të konsumuara prej kafshëve të punës, sipas llojit të ushqimeve (koncentrate, të njoma, të thata). Të gjitha fermat pavarësisht nga madhësia dhe veprimtaria duhet të blejnë mallra dhe shërbime të ndryshme. Blerja e mallrave në fermën bujqësore, varet nga lloji i veprimtarisë së saj dhe drejtimi i prodhimit bujqësor apo blegtoral. Disa nga faktorët që i mundësojnë funksionin e blerjes janë: organizimi, procesi i punës, teknologjia e prodhimit, kërkesat e veçanta të blerjes, numri i furnizuesve etj. Procesi i blerjes shpesh duket i ndryshëm kur kemi të bëjmë me nevojat e ardhshme ose me blerjen e mallit për përdorim. Kur jemi duke blerë mallin, duhet të bëjmë dallimin mes mallit për përdorim e mallit për magazinim. Kjo sepse për mallrat që duhen për magazinimin ne duhet të llogarisim edhe shpenzimet e ruajtjes, paketimit, ambalazhimit etj. Shpenzimet të cilat shkaktohen nga blerja quhen shpenzimet e veçanta të blerjes. Në këto shpenzime bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet që kanë varësi të drejtpërdrejtë me blerjen p.sh: shpenzimet e kontaktimit me furnizuesit. Ndërsa shpenzimet të cilat i shkakton materiali apo malli i blerë gjatë kohës së mbajtjes në magazinë quhen shpenzimet e veçanta të mbajtjes së magazinimit. Shembull i këtyre shpenzimeve janë shpenzimet e kamatës, të ruajtjes dhe shpenzimet e trajtimit. Sasia optimale më e volitshme e blerjes është ajo pranë shumës më të ulët vjetore të shpenzimeve të veçanta të blerjes dhe magazinimit. Shpenzimet e veçanta vjetore të blerjes zvogëlohen pranë blerjes së sasisë më të madhe menjëherë, ndërsa me shpenzimet e veçanta të mbajtjes së magazinës është e kundërta. Sasia më e mirë e blerjes është ajo e cila e minimizon shumën e shpenzimeve të veçanta të blerjes dhe të magazinimit ***Një sistem kontrolli i brendshëm është një sistem i tërë kontrollesh financiare dhe jo-financiare të vendosura nga drejtuesit me synim që të sigurohet vazhdimësia e funksionimit të njësisë ekonomike në mënyrë efektive dhe të rregullt dhe se janë zbatuar objektivat dhe politikat e menaxhimit. Gjithashtu, procedurat inkurajojnë efikasitetin operativ, përputhjen me ligjet dhe rregulloren, mbrojnë mjetet nga vjedhja dhe shpërdorim, dhe prodhojnë të dhëna kontabël të sakta dhe të besueshme.*** Veprimet ekonomike kryesore që kryhen në një ndërmarrje janë blerja e shitja e mallrave, likuidimi i detyrimeve ndaj furnitorëve e arkëtimi i të drejtave ndaj klientëve, si dhe llogaritja e pagimi i pagave të punonjësve. Të gjithë këto veprime pasqyrohen në dokumente kontabël, të cilat kanë për qëllim të ruajnë gjurmën e datës së veprimit ekonomik, natyrës, sasisë dhe vlerës së tij. Duke pasqyruar datën e kryerjes së veprimit, dokumentet kontabël janë ***burimi historik*** i veprimeve ekonomike, duke pasur përmbajtje materiale (ato janë shkresa të përpiluara me një sërë të dhënash) dokumentet kontabël përbëjnë ***provën materiale*** të veprimeve të kryera dhe duke qënë të nënshkruara nga personat përgjegjës për kryerjen e veprimeve ekonomike, ato përbëjnë edhe ***mbështetjen juridike*** të këtyre veprimeve. Blerja e mallrave mbështetet në një kontratë që ndërmarrja blerëse ka lidhur me ndërmarrjen shitëse.